



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade and Innovation

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

**SESSION INFORMUES LIDHUR ME SKEMËN E GRANTEVE PËR PËRKRAHJE
FINANCIARE TË NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM)
NË SEKTORIN E INDUSTRISË KREATIVE**

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), përkatësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), njofton të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) se, në kuadër të hapjes së thirrjes publike për Industrinë Kreative, do të organizojë një sesion informues.

Sesioni informues do të mbahet më 07 prill 2026, duke filluar nga ora 10:00, në Qendrën e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike të Universitetit të Prishtinës.

Gjatë këtij sesioni, pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të informohen në mënyrë të detajuar për të gjitha aspektet e procesit të aplikimit, duke përfshirë procedurat, kriteret e pranueshmërisë, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

Po ashtu, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të parashtrojnë pyetje dhe të marrin sqarime të drejtpërdrejta lidhur me çështjet që i interesojnë në kuadër të kësaj skeme.

Ftohen të gjitha ndërmarrjet e interesuara që të marrin pjesë në këtë sesion informues.